



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr.12, datë 06.11.2018

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I HEC-EVE
MESMAL 1,2,3 DHE SELCA 2”, NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË LUMIT TË SELCËS
DHE VELÇANIT, BASHKIA MALIQ, QARKU KORÇË”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,


VENDOSI:

1. Miratimin m kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i HEC-eve Mesmal 1,2,3 dhe Selca 2”, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Selcës dhe Velçanit, Bashkia Maliq, Qarku Korçë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Energjia Valamara” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) amendimit të kontratës së konçesionit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas legjislacionit sektorial në fuqi.
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Maliq.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

